



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2024 – Numri: 134

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E enjte, 1 gusht 2024

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 502, datë 1.8.2024	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 325, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”, të ndryshuar..... 16257
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 503, datë 1.8.2024	Për disa ndryshime në vendimin nr. 328, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”... 16258
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 530, datë 1.8.2024	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 568, datë 6.10.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit, orët shtesë dhe kompensimin e tyre në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore”..... 16265



VENDIM
Nr. 502, datë 1.8.2024

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË VENDIMIN NR. 325, DATË 31.5.2023,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
MIRATIMIN E STRUKTURËS SË
PAGAVE, NIVELEVE TË PAGAVE DHE
SHTESAVE TË TJERA MBI PAGË TË
ZËVENDËSMINISTRIT,
FUNKSIONARËVE TË KABINETEVE,
PREFEKTIT, NËNPREFEKTIT,
NËPUNËSVE CIVILË DHE
NËPUNËSVE NË DISA INSTITUCIONE
TË ADMINISTRATËS PUBLIKE”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “a”, të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 35/2023, “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”, të shkronjës “h”, të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, dhe të neneve 7 e 9, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, strukturat dhe shpërblimet e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në lidhjen nr. 3, të vendimit nr. 325, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Pika 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“5. Në Kryeministrit:

a) në masën 65 000 (gjashtëdhjetë e pesë mijë) lekë në muaj, për nëpunësin në pozicionin “Sekretar i Përgjithshëm”;

b) në masën 26 000 (njëzet e gjashtë mijë) lekë në muaj, për funksionarin në pozicionin “drejtor i kabinetit të Kryeministrit”;

c) në masën 75 000 (shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë në muaj, për nëpunësin në pozicionin “drejtor departamenti” në departamentin përgjegjës për aktet rregullatore të Këshillit të Ministrave;

ç) në masën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë në muaj, për nëpunësit në pozicionet “jurist” dhe “koordinator”, në departamentin përgjegjës për aktet rregullatore të Këshillit të Ministrave;

d) në masën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë në muaj, për nëpunësit në pozicionet “drejtor drejtorie”, “përgjegjës sektori” dhe “specialist” në departamentin përgjegjës për aktet rregullatore të Këshillit të Ministrave;

dh) në masën 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekë në muaj për nëpunësit/funksionarët në pozicionin “drejtor i kabinetit të zëvendëskryeministrit” dhe “drejtor departamenti” në departamentet përgjegjëse për aktet ligjore prioritare të Këshillit të Ministrave dhe për politikën, integrimin evropian dhe mirëqeverisjen;

e) në masën 24 000 (njëzet e katër mijë) lekë në muaj për nëpunësit në pozicionet:

i. “drejtor njësie”, në departamentet përgjegjëse për aktet ligjore prioritare të Këshillit të Ministrave dhe për politikën, integrimin evropian dhe mirëqeverisjen;

ii. “drejtor drejtorie” në departamentet përgjegjëse për politikën, integrimin dhe mirëqeverisjen, dhe për aktet ligjore prioritare të Këshillit të Ministrave.

ë) në masën 20 000 (njëzet mijë) lekë në muaj për nëpunësit në pozicionet “jurist” dhe “koordinator”, në departamentin përgjegjës për aktet ligjore prioritare të Këshillit të Ministrave;

f) në masën 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj, për nëpunësit në pozicionet “koordinator”, në departamentin përgjegjës për politikën, integrimin evropian dhe mirëqeverisjen dhe përgjegjës i sektorit, që mbulon buxhetin dhe financën;

g) në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë në muaj, për nëpunësit/funksionarët në pozicionet:

i. “këshilltar” në kabinetin e Kryeministrit dhe të zëvendëskryeministrit;

ii. “drejtor departamenti”, në departamentin përgjegjës për administrimin;

iii. “drejtor njësie” në njësinë përgjegjëse për buxhetin dhe administrimin;

iv. “drejtor drejtorie” me funksione të nëpunësit zbatues, sipas legjislacionit të menaxhimit buxhetor e financiar;



v. “koordinator” në njësinë e menaxhimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm.”.

b) Pas pikës 27 shtohet pika 28, me këtë përmbajtje:

“28. Në Agjencinë e Zhvillimit të Territorit:

a) nëpunësi në pozicionin “titullar i institucionit”, në masën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë në muaj;

b) nëpunësit në pozicionet “drejtor drejtorie” të drejtorive të përmbajtjes, në masën 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë në muaj;

c) nëpunësit në pozicionet “përgjegjës sektori” dhe “specialist” në njësitë organizative të përmbajtjes, në masën 45 000 (dyzet e pesë mijë) lekë në muaj.”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, fillojnë nga data 1 korrik 2024 dhe për vitin 2024 përballohen nga fondet buxhetore të miratuara, si dhe nga fondi i kontingjencës për rritjen e pagave, sipas përcaktimeve në ligjin nr. 97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, të ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 503, datë 1.8.2024

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 328, DATË 31.5.2023, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KLASIFIKIMIN E FUNKSIONEVE, GRUPIMIN E NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE, PËR EFEKT PAGE, DHE CAKTIMIN E KUFIJVE TË PAGAVE TË FUNKSIONARËVE TË ZGJEDHUR E TË EMËRUAR, TË NËPUNËSVE CIVILË E TË PUNONJËSVE ADMINISTRATIVË TË NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 2, shkronjat “a” e “ç”, dhe 9, të ligjit nr. 35/2023, “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”, dhe të neneve 54 e 77, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, me

propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 328, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Kategoritë dhe klasat për pozicionet e punës, elementet përbërëse të pagës bruto mujore dhe vlerat për secilin element, për funksionarët e kabineteteve dhe për nëpunësit civilë janë, si më poshtë vijon:

a) Kategoritë dhe klasat për pozicionet e punës së nëpunësve civilë përcaktohen në kolonat 1 dhe 2, të lidhjeve përkatëse nr. 2 deri në nr. 7, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij;

b) Paga për pozicion, që shpërblen vlerën relative të çdo pozicioni pune, përcaktohet sipas kufijve minimalë dhe maksimalë në kolonën 5, të lidhjeve përkatëse, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij;

c) Shtesa e nivelit të kualifikimit, që shpërblen nivelin arsimor të kërkuar për pozicionin përkatës të punës, përcaktohet në kolonën 4, të lidhjeve përkatëse, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij. Vlerat e pagës së grupit, për çdo nivel të studimeve universitare, përcaktohen në lidhjen nr. 9, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

ç) Shtesa për vjetërsi në punë jepet në masën:

i. 0,6% pas çdo viti pune për 10 (dhjetë) vitet e para (1–10 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;

ii. 0,8% pas çdo viti pune për 10 (dhjetë) vitet e dyta (11–20 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;

iii. 1% pas çdo viti pune për 10 (dhjetë) vitet e treta (21–30 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit.

Për efekt të llogaritjes së shtesës së vjetërsisë, “vite pune” do të konsiderohet vjetërsia e përgjithshme në punë, e dokumentuar në librezën e



punës së çdo punonjësi apo, në mungesë të librezës së punës, me çdo dokument tjetër ligjor, të lëshuar nga organet kompetente përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi, me përjashtim të viteve të sigurimit vullnetar, vetëpunësimit, shërbimit ushtarak të detyrueshëm, viteve të shkollimit në institucionet e arsimit të lartë dhe periudhës së trajtimit me pagesë papunësie.

d) Shtesa për kushte pune (natyrë të veçantë pune).”.

2. Pika 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“5. Klasat e pagave për pozicionet “sekretar” janë, si më poshtë vijon:

a) Sekretar i kryetarit të Bashkisë Tiranë, klasa IV-2, e lidhjes nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

b) Sekretar i kryetarëve të bashkive të tjera, klasa IV-4, e lidhjeve nr. 3, nr. 4, nr. 5 e nr. 6, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij, në përputhje me numrin e banorëve të secilës bashki;

c) Sekretar i kryetarit të Këshillit të Qarkut Tiranë, klasa IV-4, e lidhjes nr. 7, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

3. Pika 6 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“6. Klasat e pagave për funksionarët e kabineteve janë, si më poshtë vijon:

a) Drejtori i kabinetit në Bashkinë e Tiranës dhe sekretari i Këshillit Bashkiak të Tiranës, klasa I-4, e lidhjes nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

b) Këshilltari i kryetarit të Bashkisë së Tiranës dhe zëdhënësi, klasa II-1, e lidhjes nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

c) Drejtori i kabinetit i Këshillit të Qarkut dhe sekretari i Këshillit të Qarkut, klasa I-5, e lidhjes nr. 7, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

ç) Këshilltari i kryetarit të Këshillit të Qarkut dhe zëdhënësi, klasa II-2, e lidhjes nr. 7, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

d) Drejtori i kabinetit dhe sekretari i Këshillit Bashkiak:

i. për bashkitë me 100 001 deri në 200 000 banorë, si dhe me mbi 200 000 banorë, klasa I-5, e lidhjeve nr. 3 dhe nr. 4, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij;

ii. për bashkitë me 50 001 deri në 100 000 banorë, si dhe për bashkitë me deri në 50 000 banorë, klasa II-2, e lidhjeve nr. 5 dhe nr. 6, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

dh) Këshilltari i kryetarit të Bashkisë dhe zëdhënësi:

i. për bashkitë me 100 001 deri në 200 000 banorë, si dhe me mbi 200 000 banorë, klasa II-2, e lidhjeve nr. 3 dhe nr. 4, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij;

ii. për bashkitë me 50 001 deri në 100 000 banorë, si dhe për bashkitë me deri në 50 000 banorë, klasa III-2, e lidhjeve nr. 5 dhe nr. 6, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.”.

4. Lidhjet nr. 1, nr. 2, nr. 3, nr. 4, nr. 5, nr. 6, nr. 7, nr. 8, nr. 9 dhe nr. 10 zëvendësohen me lidhjet nr. 1, nr. 2, nr. 3, nr. 4, nr. 5, nr. 6, nr. 7, nr. 8 dhe nr. 9, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

5. Në pikën nr. 7, togfjalëshi “... sipas lidhjes nr. 9 ...” zëvendësohet me “... sipas lidhjes nr. 8 ...”.

6. Në pikën nr. 8, togfjalëshi “... në lidhjet nr. 1 deri nr. 9 ...” zëvendësohet me “... në lidhjet nr. 1 deri në nr. 8 ...”.

II. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, fillojnë nga data 1 shtator 2024 dhe për vitin 2024 përballohen:

1. për nivelet e pagave, sipas kufirit minimal, nga fondi i kontingjencës për rritjen e pagave, sipas përcaktimeve në ligjin nr. 97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, të ndryshuar;

2. për çdo nivel page, të miratuar mbi kufirin minimal e deri në kufirin maksimal, nga të ardhurat e veta të njësive të vetëqeverisjes vendore.

III. Ngarkohen njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



Lidhja nr. 1

Kufijtë e pagave mujore, për funksionarët e zgjedhur të organeve përfaqësuese dhe ekzekutive të njësive të vetëqeverisjes vendore

a) Për Bashkinë e Tiranës:

Emërtimi	Kufiri minimal në lekë në muaj	Kufiri maksimal në lekë në muaj
Kryetar	268,000	318,750
Nënkryetar	205,000	270,000

b) Për njësitë e vetëqeverisjes vendore me mbi 200 001 banorë:

Emërtimi	Kufiri minimal në lekë në muaj	Kufiri maksimal në lekë në muaj
Kryetar	255 000	290,000
Nënkryetar	180,000	225,000

c) Për njësitë e vetëqeverisjes vendore me 50 001–200 000 banorë:

Emërtimi	Kufiri minimal në lekë në muaj	Kufiri maksimal në lekë në muaj
Kryetar	205,000	260,000
Nënkryetar	170,000	205,000

ç) Për njësitë e vetëqeverisjes vendore me deri në 50 000 banorë:

Emërtimi	Kufiri minimal në lekë në muaj	Kufiri maksimal në lekë në muaj
Kryetar	185,000	240,000
Nënkryetar	157,000	185,000

d) Për Këshillin e Qarkut:

Emërtimi	Kufiri minimal në lekë në muaj	Kufiri maksimal në lekë në muaj
Kryetar	205,000	260,000
Nënkryetar	170,000	205,000

Lidhja nr. 2

Nivelet e pagave për nëpunësit civilë në Bashkinë e Tiranës

Kategoria	Klasa	Emërtesat e pozicioneve të punës për çdo kategori	Grupi i diplomës	Paga për pozicion
1	2	3	4	5
I	I-2	Sekretar i Përgjithshëm	1	Nga 105,000 deri 217,000
	I-4	Drejtor i drejtorive të përgjithshme të përmbajtjes (përgjegjëse për çështjet e zhvillimit dhe politikave që mbulon njësia e vetëqeverisjes vendore, si dhe për çështjet rregullatore)	1	Nga 95,000 deri 180,000
	I-5	Drejtor i drejtorive të përgjithshme mbështetëse	1	Nga 95,000 deri 170,000



II	II-1	Drejtor i drejtorive të përmbajtjes (përgjegjëse për çështjet e zhvillimit dhe politikave që mbulon njësia e vetëqeverisjes vendore, si dhe për çështjet rregullatore) Drejtor drejtorie me funksione të nëpunësit zbatues, sipas legjislacionit të menaxhimit buxhetor e financiar	1	Nga 85,000 deri 155,000
	II-2	Drejtor i drejtorive mbështetëse	1	Nga 85,000 deri 141,000
III	III-1	Përgjegjës sektori	1	Nga 75,000 deri 115,000
	III-2	Përgjegjës sektori	1	Nga 70,000 deri 105,000
IV	IV-1	Specialist Inspektor	1 ose 2	Nga 60,000 deri 90,000
	IV-2	Specialist	1 ose 2, ose 3	Nga 45,000 deri 80,000
	IV-3	Specialist	1 ose 2, ose 3	Nga 42,000 deri 70,000

Lidhja nr. 3**Nivelet e pagave për nëpunësit civilë në bashkitë me mbi 200.000 banorë**

Kategoria	Klasa	Emërtesat e pozicioneve të punës për çdo kategori	Grupi i diplomës	Paga për pozicion
1	2	3	4	5
I	I-3	Sekretar i Përgjithshëm	1	Nga 100,000 deri 205,000
	I-5	Drejtor i Përgjithshëm	1	Nga 95,000 deri 170,000
II	II-2	Drejtor drejtorie	1	Nga 85,000 deri 141,000
III	III-2	Përgjegjës sektori	1	Nga 70,000 deri 105,000
	III-3	Përgjegjës sektori	1	Nga 65,000 deri 98,000
IV	IV-2	Specialist Inspektor	1 ose 2, ose 3	Nga 45,000 deri 80,000
	IV-3	Specialist	1 ose 2 ose 3	Nga 42,000 deri 70,000
	IV-4	Specialist.	1 ose 2 ose 3	Nga 40,000 deri 60,000



Lidhja nr. 4

Nivelet e pagave për nëpunësit civilë në bashkitë me 100.001–200.000 banorë

Kategoria	Klasa	Emërtesat e pozicioneve të punës për çdo kategori	Grupi i diplomës	Paga për pozicion
1	2	3	4	5
I	I-4	Sekretar i Përgjithshëm	1	Nga 95,000 deri 180,000
	I-5	Drejtor i Përgjithshëm	1	Nga 95,000 deri 170,000
II	II-2	Drejtor drejtorie	1	Nga 85,000 deri 141,000
III	III-2	Përgjegjës sektori Kryeinspektor	1	Nga 70,000 deri 105,000
	III-3	Përgjegjës sektori	1	Nga 65,000 deri 98,000
IV	IV-2	Specialist Inspektor	1 ose 2 ose 3	Nga 45,000 deri 80,000
	IV-3	Specialist	1 ose 2 ose 3	Nga 42,000 deri 70,000
	IV-4	Specialist	1 ose 2 ose 3	Nga 40,000 deri 60,000

Lidhja nr. 5

Nivelet e pagave për nëpunësit civilë në bashkitë me 50.001 - 100.000 banorë

Kategoria	Klasa	Emërtesat e pozicioneve të punës për çdo kategori	Grupi i diplomës	Paga për pozicion
1	2	3	4	5
I	I-4	Sekretar i Përgjithshëm	1	Nga 95,000 deri 180,000
II	II-2	Drejtor drejtorie	1	Nga 85,000 deri 141,000
III	III-2	Përgjegjës sektori Kryeinspektor	1	Nga 70,000 deri 105,000
	III-3	Përgjegjës sektori	1	Nga 65,000 deri 98,000
IV	IV-2	Specialist Inspektor	1 ose 2 ose 3	Nga 45,000 deri 80,000
	IV-3	Specialist	1 ose 2 ose 3	Nga 42,000 deri 70,000
	IV-4	Specialist	1 ose 2 ose 3	Nga 40,000 deri 60,000



Lidhja nr. 6

Nivelet e pagave për nëpunësit civilë në bashkitë me deri 50.000 banorë

Kategoria	Klasa	Emërtesat e pozicioneve të punës për çdo kategori	Grupi i diplomës	Paga për pozicion
	1			5
I	I-5	Sekretar i Përgjithshëm	1	Nga 95,000 deri 170,000
II	II-2	Drejtor drejtorie	1	Nga 85,000 deri 141,000
	III-2	Përgjegjës sektori Kryeinspektor	1	Nga 70,000 deri 105,000
	III-3	Përgjegjës sektori	1	Nga 65,000 deri 98,000
IV	IV-3	Specialist Inspektor	1 ose 2 ose 3	Nga 42,000 deri 70,000
	IV-4	Specialist	1 ose 2 ose 3	Nga 40,000 deri 60,000

Lidhja nr. 7

Nivelet e pagave për nëpunësit civilë në Këshillin e Qarkut

Kategoria	Klasa	Emërtesat e pozicioneve të punës për çdo kategori	Grupi i diplomës	Paga për pozicion
1	2	3	4	5
I	I-5	Sekretar i Përgjithshëm	1	Nga 95,000 deri 170,000
II	II-2	Drejtor drejtorie	1	Nga 85,000 deri 141,000
III	III-2	Përgjegjës sektori	1	Nga 70,000 deri 105,000
	III-3	Përgjegjës sektori	1	Nga 65,000 deri 98,000
IV	IV-2	Specialist. Inspektor	1 ose 2 ose 3	Nga 45,000 deri 80,000
	IV-3	Specialist	1 ose 2 ose 3	Nga 42,000 deri 70,000
	IV-4	Specialist	1 ose 2 ose 3	Nga 40,000 deri 60,000



Lidhja nr. 8

Kufijtë e pagave për administratorët e njësive administrative

	Pozicioni	Kufiri minimal i pagës në lekë në muaj	Kufiri maksimal i pagës në lekë në muaj
1.	Administrator në njësitë administrative me 50.001–100.000 banorë	100,000	180,000
2.	Administrator në njësitë administrative me 20.001–50.000 banorë	80,000	155,000
3.	Administrator në njësitë administrative me 5.001 –20.000 banorë	65,000	145,000
4.	Administrator në njësitë administrative me më pak se 5.000 banorë	65,000	140,000

Lidhja nr. 9

Vlera e shtesës së nivelit të kualifikimit

Grupi i diplomës	Niveli i kualifikimit sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK)	Vlera e shtesës së nivelit të kualifikimit (lek/muaj)
1	Niveli 7 i KSHK-së (Master i shkencave, Master i arteve. “Master profesional të përfutur në fund të studimeve të ciklit të dytë, me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike.”. Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë.)	14 000
2	Niveli 7 i KSHK-së (Master profesional Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë.)	12 000
3	Niveli 6 i KSHK-së (Bachelor Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë.)	10 000



VENDIM

Nr. 530, datë 1.8.2024

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË VENDIMIN NR. 568, DATË 6.10.2021,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR
KOHËZGJATJEN E PUNËS DHE TË
PUSHIMIT, ORËT SHITESË DHE
KOMPENSIMIN E TYRE NË
INSTITUCIONET E ADMINISTRATËS
SHTETËRORE, INSTITUCIONET E
PAVARURA DHE NJËSITË E
VETËQEVERISJES VENDORE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 40, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të neneve 76, 78, 79, 83, 85, 86, 87, 94, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të pikës 5, të nenit 7, të ligjit nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 568, datë 6.10.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit, orët shtesë dhe kompensimin e tyre në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në kreun II bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Kohëzgjatja ditore e orëve të punës për të punësuarit në institucionet e administratës shtetërore, nga e hëna në të enjte, është 8 orë e 30 minuta, ndërsa ditën e premte është 6 orë. Për këto institucione:

a) aplikohet orari ditor fleksibël, me kushtin që brenda ditës të plotësohen orët e plota të punës, sipas përcaktimit në këtë pikë;

b) orari i detyrueshëm, kur të gjithë të punësuarit duhet të jenë në vendet e punës, nga e hëna në të enjte, është 9:30 – 15:30, ndërsa ditën e premte 9:30 – 13:00.”.

b) Pas pikës 2 shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

“2/1. Orari ditor i punës për të punësuarit në institucionet e pavarura dhe në njësitë e vetëqeverisjes vendore përcaktohet në rregulloren e brendshme të institucionit.”.

2. Në kreun III bëhen këto shtesa:

a) Në fund të pikës 2 shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“Titullari i institucionit/sekretari i përgjithshëm ka të drejtë ta delegojë kompetencën e përcaktimit të kohës së kryerjes së pushimit vjetor të paguar të drejtuesi i njësisë së burimeve njerëzore të institucionit.”;

b) Në fund të pikës 15 shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“Titullari i institucionit/sekretari i përgjithshëm ka të drejtë ta delegojë kompetencën e përcaktimit të kohëzgjatjes së pushimit pa të drejtë page të drejtuesi i njësisë së burimeve njerëzore të institucionit.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2024

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006



Çmimi 48 lekë